



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË
DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM
Nr.92, datë 28.07.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR
NR. 12, DATË 16.02.2018 PËR "LICENCIMIN E SH.A UJËSJELLËS KANALIZIME
TEPELENË PËR NDRYSHIM DREJTUESI TEKNIK"

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (**VKM nr.958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 28.07.2020 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi kërkesën e shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tepelenë sh.a. (**UK Tepelenë**) për ndryshim të licencës për shkak të ndryshimit të drejtuesit teknik.",

Vëren se:

1. Shoqëria UK Tepelenë me shkresën nr. 245 prot. datë 09.07.2020, me lëndë "Kërkesë për ndryshim licence" ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Tepelenë për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.
3. ERRU ka licencuar shoqërinë UK Tepelenë me vendimin nr. 15, datë 28.04.2017 "Për licencimin e sh. a Ujësjiellës Kanalizime Tepelenë", (**vendimi i KKRR nr. 15 i ndryshuar**) me një afat 4 vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi teknik i shoqërisë UK Tepelenë sh.a. plotëson kërkesat e VKM nr. 958 mbi profilin e edukimit.
5. ERRU në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Tepelenë sh.a të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Tepelenë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit të KKRR nr. 12, datë 16.02.2018 “Për licencimin e sh.a Ujësjellës Kanalizime Tepelenë për ndryshim drejtuesi teknik” bëhet ndryshimi si më poshtë:

“Drejtues Teknik Myftar Beqo”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani